



*U.S. Embassy Tirana, Albania
Ambasada e Sh.B.A. në Tiranë, Shqipëri*

6 mars 2007

Raporti i Departamentit të Shtetit mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut për 2006

SHQIPËRIA

Seksioni 2 Respekti për Liritë Civile, Përfshi:

a. Liria e Fjalës dhe Shtypit

Kushtetuta dhe ligji sigurojnë lirinë e fjalës dhe të shtypit dhe qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta në praktikë. Ndërkohë që media ishte aktive dhe kryesisht e papenguar, pati probleme serioze me përdorimin e medias për qëllime politike.

Politizimi i medias mbeti një çështje që përbënte shqetësim dhe në periudhën përpara zgjedhjeve vendore të planifikuara për në Janar 2007, u duk se ishte në rritje në tremujorin e fundit të vitit. Polarizimi i organeve të medias në kampe kundërshtarë është bërë më i theksuar. Botuesit dhe pronarët e gazetave vazhduan të diktonin artikuj për t'u shërbyer interesave të tyre ekonomike dhe politike dhe disa here bllokuan artikuj që binin në kundërshtim me ato interesa. Gazetarët vazhduan të praktikonin autocensurën dhe pati pak transparencë në financimin e medias.

Në përgjithësi, individët mund ta kritikonin lirisht qeverinë dhe veprimet e saj në median e shkruar dhe elektronike. Megjithatë, në maj, lëvizja aktiviste *Mjaft!* Raportoi që policia pengoi përpjekjet e saj për të shpërndarë një poster që kritikonte kryeministrin. Pasi afro 1,000 postera u vendosën në qytetin e Tiranës, forcat e policisë sipas raportimeve i zhvendosën posterat dhe konfiskuan pjesën e mbetur prej 4,000 që nuk ishin vendosur. Nuk pati raportime që zyrtarët të përdornin apo kërcënonin të përdornin padi për shpifje për të kufizuar diskutimin e lirë politik.

Media e shkruar e pavarur ishte aktive por shtrëngohej nga profesionalizmi i kufizuar, mungesa e financimeve, dhe presioni politik. Partitë politike, sindikatat dhe shoqëritë e grupet e ndryshme botuan gazetatat apo revistat e tyre të pavarura nga ndikimi i qeverisë. Në dispozicion ishin afro 200 botime, përfshi gazeta, revista të përditshme e të

përjavshme, buletine e pamflete. Një gazete e përditshme kombëtare madhore, *Shqip*, filloi botimin në pranverë, ndërkohë që dy të tjera, *Dita* dhe *Express*, u mbyllën.

Sipas të dhënave zyrtare, ekzistonin 64 stacione televizive dhe 44 stacione radiofonike, por numri faktik raportohej të ishte më i madh. Ndërkohë që stacionet funksiononin të lira nga ndikimi i drejtpërdrejtë qeveritar, shumica e pronarëve besonin që përmbajtja e transmetimeve të tyre mund të ndikonte veprimet qeveritare ndaj bizneseve të tyre të tjera.

Radio dhe Televizioni Publik Shqiptar (RTVSH) operonte një kanal televiziv kombëtar dhe një radiostacion kombëtar. RTSH ia përkushtoi shumicën e pasqyrit qeverisë dhe partisë në pushtet. Me ligj, qeveria siguron 50 të buxhetit të stacionit. Gjatë vitit, Kiço Blushi, kryetar i Këshillit Drejtues të RTSH dha dorëheqjen në shenjë proteste ndaj shtyrjes nga parlamenti për të shkarkuar drejtorin e televizionit Artur Zheji. Blushi pretendoi që RTSH ishte ende peng i politikës dhe qeverisë, duke dështuar kështu në përmbushjen e misionit të vet publik.

Në maj, parlamenti amendoi Ligjin për Median Elektronike, duke ristrukturuar Këshillin Drejtues të RTSH dhe Këshillin Kombëtar të Radio Televizionit, i cili është përgjegjës për licensimin, rregullimin, dhe duke shkarkuar anëtarët e mëparshëm të këshillit. Opozita akuzoi që ligji i ri ishte një manovër politike që synonte të dobësonte pavarësinë e dy organeve rregullatore duke i shtyrë ato në favor të qeverisë. Amendamentet gjithashtu kërkonin emërimin e profesionistëve të medias dhe përfaqësues të shoqërisë civile në vend të përfaqësuesve të partive politike.

Në kontrast me vitin 2005, pati vetëm një raportim se policia apo zyrtarë të tjerë abuzuan fizikisht gazetarët. Në shkurt, një gazetar televiziv akuzoi oficerin e policisë Kastriot Caushi të Komisarariatit të Policisë Lushnje dhe anëtarë të Gardës së Republikës se kishin përdorur forcën për të penguar gazetarët të intervistonin presidentin. Gazetari pati dëmtime të lehta nga incidenti.

Në vitin 2005, zyrat e gazetës më të madhe *Shekulli* u dëmtuan kur një eksploziv u hodh në ballkon. Pati dëmtime të zyrës, megjithëse nuk pati dëmtime të ndonjë personi. Një zëdhënës i gazettes raportoi që çështja ishte mbyllur pa paraqitjen e akuzave formale.

Kërcënimet politike të medias vazhduan. Gazetarët vazhduan të ankoheshin se botuesit dhe redaktorët censuronin punën e tyre ose drejtpërdrejt ose tërthorazi në përgjigje të presioneve politike dhe ekonomike. Shumë gazetarë u ankuan që mungesa e kontratave të punës shpesh pengonte aftësinë e tyre për të raportuar në mënyrë objektive.

Në shtator, këshilli i ministrave miratoi një rezolutë për të nxjerrë televizionin Top Channel TV, një stacion shumë të rëndësishëm televiziv, nga një ndërtesë prone shtetërore në qendër të Tiranës. Qeveria tha se synonte ta përdorte hapësirën për të promovuar artin dhe kulturën. Duke cituar një kontratë qeraje afatgjatë me Ministrinë e

Ekonomisë, kompania akuzoi që lëvizja ishte një përpjekje për t'i bërë presion stacionit për përmbajten e tij redaksionale. Në fund të vitit, çështja vazhdonte.

Shpifja është një kundravajtje që mund të dënohet me një dënim me burg deri në dy vjet dhe një gjobë. Në krahasim me vitin e mëparshëm, gjatë vitit nuk pati raportime për çështje padish për shpifje kundër medias.

Liria e Internetit

Nuk pati kufizime nga qeveria mbi aksesin ndaj internetit apo raportime se qeveria monitoronte postën elektronike apo dhomat e bashkëbisedimeve në internet. Aksesit ndaj internetit është rritur gjatë vitit, por mbeti i kufizuar, sidomos jashtë zonave madhore urbane.